



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rr"Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 29.09.2018

V E N D I M

Nr. 153, Datë 29/09/2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
DOGANAVE "MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË"
për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.**

Konstatohet se, gjatë vitit 2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe strukturat e saj të varësisë është punuar përgjithësisht mirë për zbatimin e përgjegjësive funksionale në drejtim të mbledhjes së të ardhurave doganore, të cilat janë realizuar në masën 100.9 % kundrejt planit, pra me një tejkalim në të ardhurat e buxhetit të shtetit në *shumën 1,373 milion lekë*, por u konstatuan disa të meta e mangësi në drejtim të zbatimit të legjislacionit doganor, procedurave të zhdoganimit, administrimit të akcizës, mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike, nxjerrjes së vendimeve administrative, si dhe administrimit dhe rikuperimit të borxhit doganor, të cilat kanë sjellë për pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit *në shumën 105,142 mijë lekë*.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë" të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, sipas programit të auditimit nr. 281/1prot., datë 19.03.2018, ndryshuar me shkresën nr. 281/3prot., datë 11.05.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planit të të ardhurave për vitin 2017 rezultoi se, plani i të ardhurave për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) është përcaktuar nga Drejtoria e Analizës dhe Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave dhe si rrjedhojë DPD ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat, duke mos angazhuar strukturat e saj, sikurse është Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave (Sektori i Monitorimit të Ardhurave, Analizës dhe Statistikës), në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4, neni 24, ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kap. IV. “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave”.

Si rezultat në programimin e të ardhurave të vitit 2017, kishte rezerva, e kjo u konstatua me faktin se, gjatë vitit programimi i tyre është ndryshuar me akte normative në shumën 1,000 milion lekë gjë që ndikon në performancën e institucionit, pasi ndikon direkt në arkëtimin dhe raportimin e të ardhurave doganore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1.Rekomandimi: Strukturat e **Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave** të DPD në bashkëpunim me strukturat përkatëse të MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, të riorganizojnë dhe mundësojnë **programimin e të ardhurave** në të gjitha fazat edhe me strukturat e DPD, duke shtuar kështu bashkëpunimin për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshëm në DPD, si dhe të programohen drejt e pa rezerva.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave financiare të DPD për vitin 2017 rezultoi se :

a- Llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin” (kreditor), në fund të vitit 2017 rezultoi me **gjendje 90,361,953 lekë**. Kësaj llogarie **i mungojnë të ardhura nga zhdoganimet, të cilat janë paguar nga subjekte të ndryshme, dhe të raportuara në llogarinë Asycuda Word të DPD**, por të përdorura nga “P.. S..” SHA në shumën prej **62,861,303 lekë, veprime këto që bien ndesh me Udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 “ Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 207 “Rakordimi mujor i të ardhurave”, dhe me nenin2, pika 4 të kontratës me “P... S..” SHA me nr. 30425, datë 15.12.2014 dhe Udhëzimin i DPD nr. 3, datë 05.09.2011 “Mbi deklarimin e thjeshtuar të importeve të rastësishme nga udhëtarët dhe të mallrave me natyrë jo tregtare të dërguara me postë”, i ndryshuar. Kjo mungesë e të ardhurave gjatë vitit 2017 e cila rezultoi nga rakordimi i kryer me të dhënat e sistemit Asycuda Word i DPD dhe të dhënat e kontabilitetit ndikon direkt në arkëtimin, regjistrimin, dhe raportimin e të ardhurave doganore dhe evidentimin në pasqyrat financiare të institucionit, veprime që bien ndesh me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni 3, neni 6, neni 7 dhe neni 11. Sipas kontabilitetit, me mbylljen e financiare të vitit 2017, gjendja kreditore e llogarisë parapagese me nr. 47011 është 1,324,043,984 lekë dhe gjendja kreditore e llogarisë AW është në shumën prej 1,414,405,937 lekë.**

Diferenca prej **90,361,953 lekë** përfaqëson detyrimin e “P...S...” SHA për arkëtime të subjekteve të deklaruara si të ardhura, por të pa transferuar nga “P...S...” SHA tek llogaria e buxhetit, si dhe shuma e pagesave për deklarimet të thjeshtuara të pa debituar në llogarinë parapaguese në fund të vitit 2017 dhe aktualisht:

Diferenca Sistem-kontabilitet

90,361,303 lekë

e cila përfaqëson :

Detyrimi debitor i “P... S...” SHA në fund të vitit 2017 në shumën prej 62,861,303 lekë dhe

Pagesa për Deklarata të Thjeshtuara

në shumën prej 27,500,650 lekë.

Për pagesat e detyrimeve doganore dhe të detyrimeve të tjera të pagueshme në doganë ndërmjet DPD dhe 15 Degëve të Bankës së nivelit të dytë dhe “P...S...” SHA janë lidhur gjithsej **16** akt-marrëveshje nga viti 2013, me afat të pacaktuar.

-Nga sektori i të ardhurave dhe pagesave janë kryer aktrakordimet për të ardhurat e realizuara nga DPD me 15 Degë të Bankave, **por nuk janë kryer këto aktrakordime me “P... S...” SHA.**

b-DPD nga viti 2014 ka lidhur një aktmarrëveshje me “P...S...” SHA me nr. 30425, datë 15.12.2014, e cila në rolin e agjentit doganor kryen shërbimet financiare dhe bankare të licensuara nëpërmjet shërbimeve online - payment për llogari të DPD për çdo person fizik, juridik për detyrimet doganore, të akcizës dhe detyrime të tjera të pagueshme në doganë. Nga auditimi rezulton se në kontratë nuk janë përcaktuar personat e kontaktit që do të kryejnë rakordimet përkatëse në lidhje me ardhurat e grumbulluara, si dhe penalitetet për vonesat në mosderdhjen në kohë të ardhurave në llogarinë e DPD nga “P...S...” SHA.

Aktualisht detyrimi më datën 12.06.2018 i “P... S...” SHA është në shumën **prej 42,964,713 lekë.**

Theksohet në nenin 2 të kontratës, pika 4, se të gjitha pagesat e kryera nga çdo person fizik, juridik për detyrimet doganore, të akcizës dhe detyrime të tjera duhet të kalojnë maksimalisht deri të nesërmen në orën 10 në llogarinë B... C... të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës, sipas formatit të përcaktuar në mënyrë elektronike në sistemin informatik të Doganës.

Nga auditimi rezulton se, nga ana e P...S... nuk janë kryer derdhjet e pagesave të sipërcituara, si më poshtë vijon:

Në fund të vitit 2016 diferenca është në shumën prej 75,783,534 lekë;

Në fund të vitit 2017 diferenca është në shumën prej 62,861,303 lekë;

-Nga auditimi i Akt-Marrëveshjes me nr. 30435prot., datë 15.12.2014 të DPD me “P... S...” SHA, **u konstatua se nuk janë përcaktuar nga viti 2014 personat e kontaktit,** të cilët do të kryenin aktrakordimet përkatëse, afatet kohore të kryerjes, penalitetet për vonesat e derdhjeve të arkëtimeve të kryera nga “P...S...”SHA. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Në institucion të merren masa që të rishikohet:

a- Kontrata e lidhur me “P...S...” SHA me nr. 30425, datë 15.12.2014, e cila ka rolin e agjentit doganor në marrëveshje me DPD, duke vendosur penalitetet për mosderdhjen në kohë të të ardhurave në DPD.

b- Të caktohen personat e kontaktit në marrëdhëniet me “P...S...” SHA dhe në marrëdhëniet sipas kontratave të lidhura me bankat e nivelit të dytë dhe me DPD për kryerjen e aktrakordimeve **javore me “P...S...” SHA dhe mujore me bankat e nivelit të dytë,** duke raportuar në kohë reale të dhëna për diferencat që rezultojnë të cilat detyrimisht të evidentohen në raportin mujor të evidencës fiskale të doganës.

c- Në institucion të merren masa që të arkëtohet nga P... S... sha **shuma prej 62,861,303 lekë, e pa derdhur në DPD në fund të vitit 2017,** duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse administrative dhe ligjore, për mosarkëtimin në kohë në llogarinë e të ardhurave doganore të DPD nga Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilizimit të të Ardhurave Doganore.

3. Gjetje nga auditimi: Kontabilizimi i të ardhurave në DPD aktualisht bëhet në mënyrë sintetike nga raportimet e të dhënave nga Sektori i Analizave dhe jo në mënyrë analitike për çdo deklaratë doganore të përcaktuar në kërkesat e pikës 2 dhe 3 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.11/1, datë 28.04.2014 “Për kontabilizimin dhe raportimin e të ardhurave doganore”. Sektori i kontabilizimit të të ardhurave doganore/tatimore kryen vetëm rakordimet e statement (nxjerrje llogarie) të bankës me kreditimet e llogarisë parapaguese të gjeneruara nga Oracle dhe nuk kryen kontabilizimin e të ardhurave për çdo deklaratë, për shkak të mungesës së një programi për migrimin e të dhënave nga sistemi Asycuda në sistemin Alpha Buxhetor. Aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë veprim për dokumentimin dhe regjistrimin në debi të llogarisë parapaguese (llog nr. 4701) të deklaratave të thjeshtuara për vitin 2017, të evidentuara në Degën Doganore Tiranë, me qëllim mbylljen në sistem të tyre (AW), llogari e cila gjeneron të ardhura për DPD dhe kontabilizimin dhe raportimin në kohë të të ardhurave doganore, duke ndikuar direkt në raportimin e evidencës fiskale të doganës dhe në pasqyrat financiare të institucionit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Institucioni të marrë masat që të përfundojë implementimin e plotë të programit financiar Alpha Web (faza e dytë e prokurimit), program i cili duhet të bëjë të mundur migrimin e të dhënave nga sistemi Asycuda Word për çdo lloj deklaratë, sipas çdo subjekti fizik apo juridik dhe duke kryer njëkohësisht rakordimin me të dhënat e migruara nga bankat e nivelit të dytë ku kryhen pagesat për veprimet me doganën dhe veprimet me “P...S...” SHA, me qëllim evidentimin, regjistrimin dhe kontabilizimin e të ardhurave për çdo deklaratë (DAV, DSHA, IND) nga sektori i pagesave, garancive dhe kontabilitetit të të ardhurave, në kohën e kryerjes së çdo veprimi on-line.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të të ardhurave sipas llojit të deklaratave doganore rezultojnë mungesa të mbajtjes së aktrakordimeve në lidhje me pagesat e kryera nga subjekte të ndryshme nga Degët Doganore sipas regjistrave të deklaratave të thjeshtuara, referuar Udhëzimit nr. 3, datë 05.09.2011 të DPD “Mbi deklaratën e thjeshtuar, të importeve të rastësishme nga udhëtarët dhe të mallrave me natyrë jo tregtare të dërguara me postë”, sipas subjekteve në vlerë dhe nga Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave nuk është kryer monitorimi i këtij procesi deri në debitimin e deklaratave të thjeshtuara në AW, pasi janë konstatuar deklarata të thjeshtuara në fund të vitit 2017, në shumën prej 27,500,650 lekë, të pa regjistruara në debit të llogarisë Asycuda Word të institucionit, e cila rezultoi nga rakordimi i të dhënave të sistemit AW dhe të dhënave të sistemit të thesarit (Acruar i Qeverisë), i cili gjeneron të dhëna nga sektori i pagesave dhe të ardhurave nga veprimet e kryera nëpërmjet 15 bankave të nivelit të dytë, për pagesat për veprimtari doganore nga subjekte me natyrë tregtare dhe jo tregtare sipas dokumenteve doganore (DAV dhe DSHA dhe Deklaratave të Thjeshtuara).

Shuma prej 27 milion lekë, përfaqëson pagesat e kryera nga subjekte private për zhdoganim mallrash personale me natyrë jo tregtare të kryera në 17 Degë Doganore, e pa identifikuar me subjekte për periudhën nga viti 2013 deri me 08.03.2017, referuar Udhëzimit nr. 1, datë 07.03.2017 të DPD “Mbi Deklarimin e Thjeshtuar, për mallrat me natyrë jo tregtare të importuara rastësisht nga udhëtarë”, mbi deklarimin e thjeshtuar, shumë e cila është në kredi të llogarisë parapaguese, por e pa shoqëruar me praktikë dokumentare doganore (deklaratë doganore) në sistem Asycuda Word, në mënyrë që të bëhet e mundur debitimi i kësaj llogarie.

Kjo ka sjellë si pasojë mosrakordimin e të ardhurave sipas të dhënave të AW me të dhënat e llogarisë nr. 47011 (parapagime) të llogarisë Acrual të Qeverisë. Debitimi manual aktualisht i deklarave të thjeshtuara nuk është kryer nga Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të Ardhurave, veprime që bien ndesh me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 1, datë 07.03.2017 të DPD “Mbi Deklarimin e Thjeshtuar, për mallrat me natyrë jo tregtare të importuara rastësisht nga udhëtarët”, e cila ndikon në kontabilizimin dhe raportimin në kohë të të ardhurave doganore, duke ndikuar direkt në raportimin e evidencës fiskale të doganës dhe në pasqyrat financiare të institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Në institucion të merren masa që të mbyllen deklaratat e thjeshtuara për pagesat e kryera nga subjekte private për zhdoganim mallrash personale me natyrë jo tregtare e të kryera në 17 Degë Doganore, të rezultuara të pa debituar në sistemin Asycuda World nga periudha Maj 2013 e në vazhdim në shumën prej **27,500,650 lekë, sipas dokumenteve përkatëse.**

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të blerjeve On-line u konstatua se, nga DPD është hartuar Udhëzimi nr. 5, datë 16.07.2013 “Mbi procedurën e pagesave (e-payment) të operatorëve ekonomikë (shoqëri apo persona fizikë), në kuadër të implementimit të Sistemit të Pagesave Elektronike On-line, në një llogari bankare të centralizuar arkëtimesh, të çelur në bankat e nivelit të dytë, me emërtim “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave”, për të ardhurat doganore, të akcizës dhe detyrimeve të tjera të pagueshme në doganë”, me qëllim përcaktimin e rregullave, procedurave dhe afatet që duhet të ndiqen në procesin e realizimit të arkëtimit të të ardhurave doganore, të akcizës dhe detyrime të tjera të pagueshme në doganë në sistemin informatik Asycuda Word nëpërmjet pagesave on-line me bankat e nivelit të dytë, si dhe rakordimi i këtij procesi për efekt raportimi të evidencës së të ardhurave të detajuara (doganore/tatimore) me Degën e Thesarit Tiranë dhe Drejtorinë Operacionale të Thesarit në MFE.

Nga auditimi u konstatua se, sipas Udhëzimit nr. 5, datë 16.07.2013, evidentimin, regjistrimin dhe kontabilizimin e të ardhurave doganore deri më 28.07.2017 e ka kryer Sektori i Financës dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Buxhetit, por me ndryshimin e strukturës në DPD, referuar VKM nr. 9, datë 11.01.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e administratës doganore”, këto detyra do të kryhen nga Sektorin e Pagesave, Garancive dhe Kontabilizimin e të Ardhurave, i cili ka kaluar në varësi të Drejtorisë së Buxhetit. Nisur sa më sipër është e domosdoshme ndryshimi i Udhëzimit nr. 5, datë 16.07.2013, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave dhe përgjegjësi të të dy sektorëve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Nga institucioni të merren masa që të rishikohet Udhëzimi nr. 5, datë 16.07.2013 i DPD “Mbi procedurën e pagesave (e-payment) të operatorëve ekonomikë (shoqëri apo persona fizikë), në kuadër të implementimit të Sistemit të pagesave elektronike on-line, në një llogari bankare të centralizuar arkëtimesh, të çelur në bankat e nivelit të dytë me emërtimin “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave”, për të ardhurat Doganore, të Akcizës dhe detyrime të tjera të pagueshme në doganë”, në lidhje me përcaktimin e strukturës përkatëse si rezultat i ndryshimeve të reflektuara nga zbatimi i VKM nr. 9, datë 11.01.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e administratës doganore”, si në Degë Doganore dhe në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës në DPD, me qëllim evidentimin, regjistrimin, kontabilizimin e të

ardhurave fiskale doganore në mënyrë analitike sipas llojit të deklaratës(DAV DSHA apo IND) dhe subjekteve juridike apo fizike.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave nga Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD, rezultoi me gjendje të lartë të detyrimeve të pambledhura në fund të vitit 2017 nga borxhi doganor, në shumën prej 23,946,599,480 lekë, nga 24,787,914,753 lekë në fund të vitit 2016, dhe që i përket 4,251 vendimeve nga Degët Doganore dhe për 2,187 subjekteve debitore, ku peshën kryesore të borxhit e kanë Degët Doganore Tiranë me rreth **72.43%**, Durrës me rreth **13.30%**, Fieri me rreth **3.19%**, Vlorë me rreth **1.93%**, Berati me rreth **2.09%**, etj.

Kjo gjendje e lartë e detyrimeve (borxh doganor) ka ardhur kryesisht nga niveli i ulët i arkëtimit gjatë vitit 2017. Gjatë vitit 2017 janë pakësuar detyrimet nga borxhi doganor në shumën prej 2,972,050 mijë lekë, ku 488,598 mijë lekë i përkasin pakësimit të detyrimeve doganore si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore të fituara nga subjektet dhe anulimit të disa vendimeve të degëve doganore dhe **shuma 1,827,197 mijë lekë**, që i përket **896 subjekteve**, kryesisht nga 1,136 vendime të nxjerra nga Degët Doganore, të cilët përfituan nga falja e detyrimeve nga zbatimi i ligjit nr. 33/2017, datë 30.03.2017, nenet 9,10 dhe 11, **megjithëse rezultojnë se janë subjekte të cilët nuk janë në listën e kontribuesve të mëdhenj në të ardhurat doganore**. Borxhi doganor përbëhet nga detyrime doganore në shumën prej 6,163,272 mijë lekë, ose 26% të totalit të borxhit, penalitetet në shumën prej 15,191,925 mijë lekë, ose 63% të totalit të borxhit dhe kamat vonesa në shumën prej 2,591,402 mijë lekë, ose 11% të totalit të borxhit. Mos ndjekja dhe arkëtimi ndër vite i borxhit doganor nga Degët Doganore ka ndikuar tek të ardhurat doganore, duke ndikuar njëkohësisht në rritjen e kontribuesve të të ardhurave doganore dhe si rezultat në rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, i ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 02.04.2015 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 4, datë 07.04.2016 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1Rekomandimi: Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD në bashkëpunim me Degët Doganore, të bëjë një analizë të thelluar të rasteve të shtuara të mosarkëtimit të borxhit dhe rrugëve të zgjidhjes për rikuperimin e këtyre detyrimeve. Borxhi i lindur si rezultat i shkeljeve të legjislacionit të akcizës të analizohet sipas natyrës së lindjes së detyrimeve më qëllim parandalimin në të ardhmen.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dispozitave ligjore e nënligjore për borxhin doganor është konstatuar se Udhëzimi nr. 4, datë 07.04.2016 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, i DPD **ka nevojë të rishikohet në kuadër të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014** “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 02.04.2015, referuar nenit 291, pika 3, ku përcaktohet fusha e zbatimit pas datës 01.06.2017 për sa i përket neneve të Rikuperimit të borxhit doganor (nenet 98-99, nenet 101 dhe 116) e konkretisht në:

-Në zbatim të kërkesave të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”, në lidhje me afatet e ankimimit të vendimeve administrative të shpalljes së borxhit nga subjektet dhe mënyrës dhe afatet e pagesave të borxhit në plotësim të kushteve për ankimim nga subjektet juridike, pasi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 32,

datë 02.04.2015, pas datës 01.06.2017, kanë ndryshuar këto afate të cilat rezultojnë të ndryshme në Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016 i DPD.

-Nga auditimi i të ardhurave doganore, kontabilizimit të borxhit dhe monitorimit të procesit të rikuperimit të detyrimeve doganore dhe të akcizës rezultoi se, në Udhëzimin e DPD nr. 4, datë 07.04.2016 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika V “Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi në DPD i gjendjes së detyrimeve të papaguara” ka nevojë për ndryshime, pasi e rëndësishme është procesi i kontabilizimit dhe rakordimi i borxhit nga çdo Degë Doganore dhe raportimi në DPD, duke rritur kështu shkallën e ndjekjes dhe përgjegjësisë, si në Degët Doganore dhe në DPD (Sektori i Monitorimit të Borxhit). Duke u nisur nga pika 7 e udhëzimit me emërtesë-Raportimi në DPD, rezulton se nuk është përcaktuar mënyra dhe strukturat e hartimit të evidencave mujore të borxhit dhe raportimi në DPD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: DPD të marrë masa që gatë rishikimit të Udhëzimit nr. 4, datë 07.04.2016 të DPD, për një monitorim më efektiv dhe ndjekje të borxhit doganor nga DPD duhet më përpara se të hartohen në Degët Doganore evidencat e detyrimeve të papaguara nga subjektet (borxhi) sipas burimeve të krijimit, duhen përcaktuar strukturat përkatëse si (jurist /apo specialist i borxhit) dhe specialisti në zyrat e financës, të cilët duhet të kryejnë çdo muaj rakordimet përkatëse të borxhit sipas subjekteve në vlerë dhe sipas arkëtimit të kryera, bazuar në të dhënat nga sektori i financës. Këto evidenca të hartuara sipas të dhënave të rakordimeve të mbajtura të dërgohen çdo muaj në Sektorin e Monitorimit të Borxhit në DPD, e cila bën të mundur evidentimin në kohë të detyrimeve duke monitoruar procesin në tërësi të borxhit doganor me efektivitet.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Borxhi doganor sipas vendimeve të marra nga Degët doganore **evidentohet dhe kontabilizohet në total si borxh doganor dhe jo i ndarë si burimit të krijimit të tij** (pra i ndarë si borxh, si detyrim nga akciza apo taksë doganore). Sektori i Monitorimit të Borxhit nuk ka të dhëna për sa i përket borxhit sipas burimit të krijimit, duke e bërë të pa mundur krahasimin e të dhënave në lidhje me subjektet që zënë një peshë të konsiderueshme në krijimin e të ardhurave dhe atyre subjekteve që kanë detyrime të konsiderueshme doganore dhe që kanë përfituar nga ligji nr. 33/2017 , datë 30.03.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”. Këto veprime bien ndesh me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës nr. 4, datë 07.04.2016 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Në institucion të merren masa që të evidentohet dhe kontabilizohet borxhi doganor sipas burimeve të krijimit, duke mundësuar ndjekjen dhe rikuperimin me forcë sipas subjekteve të detyrimeve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Të dhënat për detyrimet doganore (borxhi doganor) sipas subjekteve mbahen në mënyrë manuale me dorë, si nga 17 Degët Doganore dhe në DPD, si dhe përlllogaritja e penaliteteve dhe kamatëvonesave kryhet në mënyrë manuale me dorë dhe jo në sistemin Asycuda Word. Mbajtja e detyrimeve, pra e borxhit doganor së bashku me penalitetet dhe sanksionet në

sistemin elektronik të doganës AW e bën procesin e ndjekjes dhe monitorimit të borxhit efektiv dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 4, datë 07.04.2016 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”. Kjo ndikon në ndjekjen, evidentimin, regjistrimin e të dhënave analitike të borxhit doganor sipas subjekteve, me qëllim monitorimin e borxhit doganor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Në institucion të merren masa që të bëhen ndryshime në sistemet informatike e konkretisht, në sistemin doganor Asycuda Word dhe atë financiar Alpha Web, me qëllim hartimin e një programi për detyrimet doganore, si dhe përllogaritjen e penaliteteve dhe kamatëvonesave sipas subjekteve, e cila aktualisht mbahet në mënyrë manuale me dorë, si nga 17 Degët Doganore dhe në DPD, me qëllim administrimin sa më efikas së këtij programi.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga 17 Degët Doganore për vitin 2017 janë dërguar gjithsej 1,348 urdhra ekzekutimi në zyrat e përmbarrimit gjyqësor, por nga ana e tyre nuk janë paraqitur informacione periodike në lidhje me ecurinë e ekzekutimeve të borxhit nga Përmbarrimi Gjyqësor në bazë të kontratave të lidhura, në mënyrë që të mbikëqyret dhe kontrollohet në Sektorin e Monitorimit të Borxhit arkëtimi i detyrimeve doganore nga subjektet ndër vite, duke evidentuar problematikat e mos ekzekutimeve të këtyre detyrime sipas degëve doganore, duke rritur dhe shkallën e përgjegjshmërisë së Degëve Doganore, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 4, datë 07.04.2016 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi: Në institucion të merren masa që në evidencat mujore të borxhit doganor të jepen të dhëna për shkallën e ndjekjes me forcë të borxhit doganor, ecurinë e ekzekutimeve të borxhit nga Përmbarrimi Gjyqësor në bazë të kontratave të lidhura, duke e bërë procesin e monitorimit efikas dhe të kontrolluar nga Sektori i Monitorimit të Borxhit.

Në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor në Degë Doganore, kryesisht në **Tiranë, Fier, Qafë-Thanë, Korçë dhe Kakavijë** janë pranuar transaksione të mallrave të deklaruar në kapitullin “*Mish dhe të brendshmet e tij*” me vlera statistikore më të ulëta referuar viteve deklarues 2015 dhe 2016, duke reflektuar ulje vlerash statistikore **deri në 60%** për deklarime të veçanta, ku uljen me të dukshme e paraqesin kodet tarifore ***0202 30 90***, ***0207 14 10***, ***0207 14 10***, ***0207 14 10***, ***02091011***, ***0209 10 11***, ***0202 30 90***, ***02071460***, ***02091011*** dhe që lidhen me importe të kryera nga vende të Bashkimit Europian kryesisht, Italia, Greqia, Polonia, Gjermania, etj. Konstatohet se Dega Doganore Tiranë ka nivelin më të lartë të mosndërhyrjes në vlerën e mallit, në nivelin **deri 92%**, duke trajtuar praktika me vlerë transaksioni. Dega Doganore Tiranë ka transaktuar importe mallrash të natyrës mish në sasinë deri 65% të totalit të importuar për vitin 2017 dhe ka ruajtur një nivel vlerësimi doganor shumë të ulët, në nivelin 146 lekë/kg nën vlerën e të dhënave të Disponueshme në RSH, si dhe jo të trajtuar sipas metodës alternative të vlerësimit të mallrave identikë. Dega Doganore Fier ka nivel të lartë të mosndërhyrjes në vlerën e mallit, në nivelin deri 90%, duke trajtuar praktika me vlerë transaksioni dhe ka transaktuar importe mallrash të natyrës mish në sasinë 20% të totalit të importuar për vitin 2017 dhe

duke ulur nivelin e vlerësimit doganor në nivelin 94 lekë/kg nën vlerën e të dhënave të Disponueshme në RSH, si dhe jo të trajtuar sipas metodës alternative të vlerësimit të mallrave identikë. Konstatohet se Degët Doganore Qaf-Thanë, Kapshticë, Korçë, Kakavijë kanë nivel të lartë të mosndërhyrjes në vlerën e mallit, duke trajtuar praktika me vlerë transaksioni dhe kanë transaktuar importe mallrash të natyrës mish në sasinë 9% të totalit të importuar për vitin 2017 dhe duke ruajtur një nivel të ulët vlerësimi doganor, mesatarisht të ulët në nivelin 118 lekë/kg nën vlerën e të dhënave të Disponueshme në RSH, si dhe jo të trajtuar sipas metodës alternative të vlerësimit të mallrave identikë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryejë një analizë të plotë të faktorëve dhe shkaqeve që kanë sjellë si pasojë uljen e vlerës së deklarimeve të transaksioneve të kryera deri në nivelin 60%, krahasuar kjo me të dhënat statistikore të viteve 2015 dhe 2016 për mallra identikë dhe të ngjashëm, për deklarime të mallrave të Kapitullit “Mishi dhe të Brendshmet e ngrënshme të Mishit” nga vende të Bashkimit Europian, kryesisht Italia, Greqia, Polonia, Gjermania dhe të tjerë. Bazuar në nenin 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit në DPD, nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në DPD dhe Drejtoria e Hetimit, si struktura kontrolli dhe verifikimi që monitorojnë dhe kontrollojnë edhe zbatimin e sistemeve të kontrollit në praktikë, të ndërmerren Programe Kontrolli me qëllim analizimin korrekt të konstatimeve të arritura sa më sipër, si dhe të kërkohet në vijimësi arkëtimi dhe vjelja e detyrimeve doganore për rastet e praktikave doganore që do të evidentohen gjatë ushtrimit të program kontrolleve, për periudhën 01.01.2017 deri 31.12.2017 dhe në vijim. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të nxirren përgjegjësitë konkrete të inspektorëve të Kontrollit pas Zhdoganimit, specifikisht në Degën Doganore Tiranë dhe të personelit përpunues doganor që ka trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë vlerësimin doganor të këtyre mallrave, ku problematika e këtij fenomeni është **shumë e dukshme dhe me pasoja të rënda financiare në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit**, të cilët nuk kanë ushtruar atributet ligjore sipas nenit 102 të ligjit nr. 8449, datë 24.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i shfuqizuar dhe bazuar në nenet 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Menjëherë

11.2. Rekomandimi: I rikërkojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të shfuqizojë **shkresat nr. 1945prot., datë 25.01.2016 dhe nr. 2344prot., datë 28.01.2016**, të DPD, lidhur me vlerësimin doganor të mallrave të kapitullit *02* të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, të cilat bien ndesh me kërkesat e Seksionit I të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 25, datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit...”.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Hetimit rezultuan dosje hetimore për të cilat nuk është kërkuar sekuestrimi i vlerës së mallit të cilësuar si objekt kontrabande për mjetet motorike, në procesverbalet e hartuara nga Drejtoria e Hetimit, dërguar për vendimmarrje administrative pranë degëve doganore respektive, në 5 (pesë) raste, **në shumën 2,410,459 lekë**, veprime në mosrespektim të kërkesave ligjore gjatë hartimit të akteve të konstatimit, në kundërshtim me kërkesat e neneve 256.1.b, 256.2/3, 281/1, 282/2, 289 dhe 291 të ligjit nr. 8449, datë 24.01.1999 “Kodi Doganor në RSH”, i shfuqizuar.

Në dosjen hetimore nr. 24673/3prot., të DPD, datë 07.11.2017 të ndjekur nga Drejtoria e Hetimit ka rezultuar se për sasinë prej 3,050,000 paketa cigare, ose 61,000,000 fije cigare të faturuara për llogari të shoqërisë “R...G...T...LTD” me NIPT L71712012J, të sekuestruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Departamentit Operativ-Hetimor, është kryer referimi penal pranë prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Malli kontrabandë është dorëzuar në ruajtje në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale Durrës, por nuk u administrua akti i llogaritjes së vlerës së detyrimit doganor të akcizës për mallin e sekuestruar, **në vlerën 335,500,000 lekë**, veprim jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr. 61, datë 25.08.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Drejtorisë së Hetimit pranë Departamentit Operativ-Hetimor, në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, si dhe struktura e organe të tjera hetimore dhe ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, të ndjekë në të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor dhe në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal në RSH”, i ndryshuar, që lidhet me këto vepra penale, të kërkojë sekuestrimin e mjeteve motorrike me të cilin është kryer kontrabanda për 5 raste shkeljesh doganore në **shumën 2,410,459 lekë**.

12.2. Rekomandimi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të referojë në Organin e Prokurorisë Durrës, shumën e detyrimeve doganore të akcizës në **vlerën 335,500,000 lekë**, referuar dosjes hetimore nr. 24673/3prot., datë 07.11.2017, për sasinë prej 3,050,000 paketa cigare, ose 61,000,000 fije cigare të faturuara për llogari të shoqërisë “R...G...T... LTD” me NIPT L71712012J, si dhe të gjykojë mbi referimet penale të patrajuara në përputhje me shkeljet doganore të kontrabandës, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aneksin nr. 3, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe Udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, janë deklaruar mallra me qëllim përjashtimin nga detyrimet doganore të TVSH-së, bazuar në ligjin nr. 125/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79281, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar”, neni 4, shkronja “g”, VKM nr. 180, datë 13.02.2013 pika 1, shkronja “a”, pika 3.1, si dhe ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, neni 56, pika 38/a, VKM nr. 953, datë 29.12.2014, neni 8, pika 1/a dhe 4.1 dhe VKM nr 13, datë 14.01.2015, Aneksi 1/1.

Konstatohet se, në tre raste nuk është bërë klasifikim i saktë tarifor për “Makineri dhe pajisje”, veprime në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005 “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore”, i ndryshuar, për deklarime mallrash në kreun *8705*, me detyrime doganore në **shumën 7,541,446 lekë**, si dhe nuk janë kryer verifikime konkrete në ambientet e subjekteve deklarues, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë faktike të gjendjes fizike të mallrave të përjashtuara sipas autorizimeve respektive në funksion të kryerjes së investimit, për të cilën është dhënë dhe autorizimi i përjashtimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti Teknik nëpërmjet Drejtorisë së Tarifës dhe Originës, të ndjekë përputhshmërinë ligjore të deklarimeve të kryera sipas

autorizimeve respektive me status përjashtimi nga pagesa e TVSH-së, sipas praktikave doganore të cituara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, që lidhen më artikuj të natyrës **“Makineri dhe pajisje”**, deklaruar në kreun *8705*, me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor të deklarimeve të kryera në përputhje të plotë midis VKM nr. 953, datë 29.12.2014, neni 8, pika 1/a dhe 4.1 dhe VKM nr. 13, datë 14.01.2015, Aneksi 1/ 1, si dhe kërkesave të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005 “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore”, deri në arkëtimin e plotë të detyrime doganore të TVSH-së në **shumën 7,541,446 lekë**.

13.2. Rekomandimi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti Teknik nëpërmjet Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës, në bashkëpunim dhe me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të analizojnë vlerat dhe sasitë e mallrave në praktikat doganore të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim **“verifikimin e destinacionit”** të këtyre mallrave në investimin e kryer, me status përjashtimi nga pagesa e TVSH-së, sipas deklarimeve në autorizimet respektive që lidhen me praktikat doganore, sipas aneksit nr. 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe të veprave për mospërputhjet e konstatuara në zbatim të ligjit nr. 125/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar”, neni 4, shkronja “g”, VKM nr. 180, datë 13.02.2013, pika 1, shkronja “a”, pika 3.1, dhe ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, neni 56, pika 38/a, VKM nr. 953, datë 29.12.2014, neni 8, pika 1/a dhe 4.1, VKM nr. 13, datë 14.01.2015, Aneksi 1/1, si dhe legjislacionit doganor në fuqi.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Antikontrabandës, rezultuan dosje kontrolli për të cilat nuk është kërkuar sekuestrimi i vlerës së mallit, cilësuar në procesverbalet e hartuara objekt kontrabandë, **në shumën 1,138,017 lekë**.

Rezultuan akte konstatimi të shkeljes doganore të pa dokumentuara nga Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit, për sanksione dhe detyrime doganore **në shumën 1,711,437 lekë**, dërguar për vendimmarrje administrative pranë degëve doganore, veprime këto që kanë konkluduar në mosrespektim të kërkesave ligjore gjatë hartimit të akteve të konstatimit të shkeljeve doganore jo në përputhje me kërkesat 256.1.b, 256.2/3, 281, 281/1, 289 dhe 291 ligjit nr. 8449, datë 24.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për disa raste subjektsh trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, që lidhen me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara për Drejtorinë e Antikontrabandës dhe Drejtorinë e Metodikës pranë Departamentit të Akcizës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të ndjekë të gjithë procedurat e sekuestrimit për vlera mallrash, në **shumën 2,849,454 lekë**, parashikuar nga legjislacioni doganor dhe kontabilizimin e vendimeve administrative, sipas rasteve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës“.

Deri më 31.12.2018

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat doganore për lëshimin e autorizimeve për agjentët doganorë, pranimi e çlirimi i garancive doganore dhe mbylljen e transiteve, u konstatua se:

a. Për vitin 2017, sipas sistemit Asycuda janë kryer 219,383 raste transitesh. Me shkresën nr. 18114, datë 04.08.2017 Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore, Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore, periudhën 01.01.2017-27.07.2017 raporton 99 transite të pambyllura deri në datën 05.08.2017. Për periudhën 01.08.2017-31.01.2018, transitet e pambyllura nuk janë ndjekur nga asnjë sektor. Nga auditimi rezulton se **deri në datën 25.05.2018** në sistem rezultojnë **67 raste** të pambyllura transitesh T1 dhe T2, **të mbuluara me garanci bankare në shumën 12,776,322 lekë**, për të cilat janë shkelur hapat procedural lidhur me operacionet e mbylljes së transitit.

b. Nga auditimi rezultoi se, në **12 raste** janë lejuar të kryejnë veprime përfaqësimi të tërthortë në doganë **për një periudhë mbi një muaj pa plotësuar menjëherë** kushtin e depozitimit të garancisë bankare **në shumën 50,000,000 lekë**, agjentë doganorë të licencuar si “persona juridikë” me certifikatë garancie për TC 31 për veprime doganore me transit (9 raste), ose veprime doganore pa transit (3 raste), në mospërputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 651, datë 10.11.2017, nenit 78, pika 4, germa “c”;

c. Nga auditimi rezulton se, garancia për pagesë të datës 09.01.2017, lëshuar nga BKT, protokolluar në DPD me nr. 333, datë 09.01.2017 lëshuar për aplikantin “**A...2013**” me kod J085, “Përfitues” nuk është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Format i kësaj garancie ndryshon nga formati i zakonshëm i garancive (trashësia e letrës, ngjyra e saj) dhe është format letre e zakonshme A4, e cila ndryshon nga formati i përgjithshëm që lëshon kjo bankë. Me gjithë të metat në dukje të këtij dokumenti, bazuar në këtë garanci Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore ka lëshuar certifikatë garancie TC 31, nr serial 0000517, datë 25.01.2017, me afat vlefshmëri deri 25.01.2018, në mospërputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 651, datë 10.11.2017, nenit 78, pika 4, germa “c”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare të mbikëqyrë transitet e pambyllura në sistem duke kërkuar nga:

-“**Zyrat doganore të destinacionit**” në rastin kur konfirmohet paraqitja në destinacion, në shkelje të afatit kohor për kryerjen e transitit, vendosjen e penalitetit për shkelje të afatit të mbylljes së transitit sipas legjislacionit në fuqi.

-“**Zyra doganore e nisjes**”, në rastin kur konfirmohet mosparaqitja në destinacion, të identifikohet debitorin, të rillogariten detyrimet doganore të munguara dhe të njoftohet menjëherë mbajtësi i regjimit/garantuesi për shlyerjen e regjimit brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj.

-Në rast mospagese brenda afatit ligjor nga zyra doganore e nisjes, të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të vazhduar procedurën **për prekjën e garancisë bankare të depozituar nga garantuesi në shumën 12,776,322 lekë**, për 66 transitet e pambyllura.

-Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet strukturave të saj, të konfirmojë vlefshmërinë e garancisë për pagesë të datës 09.01.2017 lëshuar nga BKT për aplikantin “**A...2013**” me kod J085, në përputhje me dispozitat në fuqi.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pas ristrukturimit është krijuar **Drejtoria e Procedurave Doganore**, e cila përbëhet nga **3 sektorë**. Gjatë vitit ushtrimor **2 sektorë** të kësaj drejtorie, nuk kanë funksionuar sipas organigramës së miratuar në përputhje me VKM nr. 9, datë 11.01.2017 pasi:

-**Sektori i Harmonizimit të Procedurave Doganore dhe Informimit të Operatorëve**, krijuar gjatë vitit 2017 si strukturë e re, referuar VKM nr. 9, datë 11.01.2017, me emërim personeli një nëpunës në cilësinë e përgjegjës sektori ka qenë jo aktive. Kjo strukturë e re ka patur si funksion

informimin e operatorëve ekonomikë për procedurat doganore, lehtësitë dhe thjeshtimet që ofron legjislacioni doganor dhe harmonizimin e udhëzimeve apo akteve e tjera të nivelit të tretë me Kodin Doganor, e cila nuk funksionoi asnjëherë me këtë objekt. Me ndryshimet e strukturës së administratës doganore, të përcaktuara në VKM nr. 2, datë 08.01.2018, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për Personelin e Administratës Doganore”, ky sektor ristrukturohet përsëri.

-Sektori i Lehtësive, Thjeshtimeve Doganore dhe Transitit referuar VKM nr. 9, datë 11.01.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014 të KM “Për personelin e administratës doganore” duhet të ishte ngritur si sektor i ri gjatë vitit 2017, sipas organigramës së miratuar, por ky sektor nuk ka funksionuar asnjëherë si strukture e veçantë dhe rezulton pa emërim personeli.

-Nga auditimi rezulton se, pas ndryshimeve pas ristrukturimit të institucionit dhe krijimit të Drejtorisë së Procedurave Doganore, referuar dispozitave ligjore të përcaktuara në VKM nr. 9, datë 11.01.2017 dhe VKM nr. 2, datë 08.01.2018, nuk ka rregullore të brendshme, urdhër apo udhëzim, të administratës doganore **që adreson përgjegjësitë për administrimin e regjimeve të transitit.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare, që bashkërendon e mbikëqyr veprimtarinë e administratës doganore të nxjerrë rregullore të brendshme, urdhër apo udhëzim, me qëllim adresimin e përgjegjësive për administrimin e regjimeve transit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Pas kontrollit aposterior nga **Sektori i Kontrollit të Regjimeve** për subjektet “S...”; “M...”; “L...”; Degët Doganore Durrës, Bllatë dhe Vlorë, kanë dalë me vendim administrativ për detyrim dhe penalitete doganore në shuma më të ulëta se kontrolli aposteriori, të cilat sipas vendimmarrjes në pjesën arsyetuese lidhen me zbatimin e ndryshëm të dispozitave ligjore, kryesisht të vendosjes së penaliteteve sipas ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar dhe VKM nr. 651, datë 10.11.2017, me efekt financiar në shumën 17,611,206 lekë.

-Pas kontrollit aposterior në terren për subjektin “G...C...” Shpk me NIPT L54424004E për program kontrollin nr. 26140, datë 14.11.2017 ka dërguar Raport Kontrolli Paraprak aposteriori dhe procesverbali nr. 1, datë 08.02.2018, në D.D.Kapshticë në datën 12.02.2018, **pra gati tre muaj me vonesë** nga përfundimi i kontrollit në terren, në mospërputhje me nenin 276/3/b të Kodit Doganor. Referuar Manualit të DPD nr. 4349/4, datë 22.04.2016 “Mbi kryerjen e kontrollit paszhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, në pikën C “Faza e tretë”, ku finalizohet mbyllja e kontrollit, bazuar në dokumentacionin provues dhe informacionit të siguruar si nga vetë grupi i kontrollit, ashtu edhe të siguruar nga vetë operatori ekonomik.

-Me Program kontrolli aposterior, nr. 20332, datë 08.09.2017 dhe nr. 20333, datë 08.09.2017 është ushtruar kontrolli tematik mbi zbatimin e legjislacionit doganor lidhur me klasifikimin tarifor, për importet e kryera për periudhën 13.09.2017 e në vazhdim, me afat kontrolli 12-16.09.2017. **Ky auditim vazhdon të jetë në proces deri në datën 14.06.2018.** Nga Degët Doganore ka rezultuar klasifikim tarifor me nivele të ndryshme taksimi për subjektet “D...” shpk, “H...” shpk dhe “E...” shpk, për artikullit “lëng frutash” me kod tarifor 20 09 me TD 15% dhe “Pije Freskuese” me kod tarifor 22 02 me TD 0%. Artikujt kanë të njëjtin eksportues dhe të njëjtin vend origjine. Kontrolli aposterior **vazhdon të mbetet në proces për një periudhë të tejzgjatur kohore edhe pas**

konfirmimit nga dogana homolge italiane sipas shkresës nr. 7930/1, datë 05.04.2018, të Drejtorisë së Informacionit. Ky veprim është në mospërputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 25, datë 30.11.2007 “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre*”, Sesionit I “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, pasi cënon standardin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit, cënon barazinë në pagesën e taksave doganore nga subjektet importues, cënon procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore për pranimin ose jo të vlerës së transaksionit të deklaruar, sipas indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, në zbatim të neneve 34-39 të Kodit Doganor Nga kontrolli aposterior “Deklaratave të thjeshtuara” Degët Doganore Vlorë, Qafë Thanë, Morinë, Blladë, Tre Urat, Sarandë, Fier për shkeljen e konstatuar nga kontrolli aposterior **nuk kanë dalë me vendim administrativ ose kanë dalë me vendim më pak se rekomandimi** i dhënë, duke mos siguruar një sistem të drejtë, uniform dhe neutral në procedurat e vlerësimit Doganor. Referuar Manualit të DPD nr. 4349/4, datë 22.04.2016 “*Mbi kryerjen e kontrollit paszhdoganimin në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore*”, në pikën C, përcaktohet se: “Për parregullsitë apo shkeljet e konstatuara grupi i kontrollit harton nga zyra, procesverbalin përkatës si dhe Raportin Paraprak të Kontrollit”, por në finalizim të kontrollit aposterior ligjet, rregulloret, manualët që rregullojnë këtë fushë, nuk kanë të miratuara procedura standarde për finalizimin e kontrollit operativ, duke mos përmbushur objektivin për të realizuar një kontroll në maksimumin e efikasitetit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare, të përmirësojë Manualin nr. 4349/4, datë 22.04.2016 “*Mbi kryerjen e kontrollit paszhdoganimin në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore*”, për të siguruar procedura që krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm që minimizojnë rrezikun e korrupsionit, sigurojnë trajtim të paanshëm për të gjithë kontrollet aposterior, reduktojnë subjektivitetin e punonjësve të administratës doganore, duke bërë të mundur mbajtjen e përgjegjësisë për të gjitha veprimet e kryera.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, si struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare të sigurojë procedura që krijojnë sisteme të kontrollit të brendshëm me qëllim zbatim e trajtim të unifikuar të zbatimit të legjislacionit doganor në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor dhe legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. nr. 424/31 prot., datë 06.10.2017 dhe protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 22774 prot., datë 09.10.2017, konkretisht:

- a. Zbatimin e rekomandimit për 5 masa organizative, të cilat nga auditimi zbatimit të rekomandimeve rezultojnë në proces zbatimi 4 masa dhe pa zbatuar 1 masë.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 10 rekomandime në shumën 153,737,116 lekë. Nga DPD nuk është pranuar 1 rekomandim në shumën 85,799,334 lekë. Janë pranuar 9 rekomandimet e tjera, nga të cilat 6 rekomandime janë zbatuar plotësisht /pjesërisht në shumën 5,280,384 lekë dhe 3 nuk janë zbatuar. Në total rekomandimet për masa shpërblim dëmi **nuk janë zbatuar në shumën 148,456,732 lekë**

c. Komisionit Disiplinës së DPD ka filluar ecurinë e masave disiplinore në Prill 2018, për 8 punonjës sipas shkeljeve të konstatuara nga auditimi i KLSH-së, të cilat janë në proces shqyrtimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqet nr. 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror dhe Degët Doganore në cilësinë e “autoritetit doganor kompetent” të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto dy institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit për kontabilizimin e shumës prej **148,456,732 lekë**, rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 424/31prot., datë 06.10.2017 dhe protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 22774prot., datë 09.10.2017.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi plotësimin e pasqyrave financiare, u konstatua se Bilanci Përmbledhës për DPD dhe 18 njësitë e varësisë së saj është depozituar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresën nr. 12637, datë 28.05.2018, pra në tejkalim të afatit të përcaktuar me mbi një muaj, po kështu dhe bilanci i aparatit është dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë jashtë afatit, që është data 28 shkurt.

-Nga analiza e pasqyrave financiare të Aparatit konstatohet se shpenzimet për investime në proces, për ndërtime dhe rikonstruksione, në shumën 20,032,655 lekë janë pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime dhe rikonstruksione”, kur duhej të regjistroheshin në llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në përfundim të punimeve dhe me marrjen në dorëzim të kalonin në llogarinë përkatëse, veprime këto në kundërshtim Kreu 2, pika 5, si dhe Kapitujt II dhe III të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998, të ndryshuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 20.01.2001 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale si dhe njësitë që varen prej tyre”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 dhe nr. 10, datë 27.02.2008. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr. 236-247 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit në DPD të marrë masa, që të bëjë rregullimet e duhura kontabile dhe pasqyrimin e saktë, si të investimeve në proces, por dhe atyre të përfunduara, kjo për një pasqyrim të saktë të aseteve të institucionit.

Nga Drejtoria e Buxhetit të merren masa për eliminimin e parregullsive të konstatuara dhe hartimin në kohë të pasqyrave financiare, me qëllim informimin në kohë të stafit menaxherial për vendimmarrjen e tyre.

Në vazhdimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, në momentin e kalimit të administrimit të llogarisë parapaguese nga degët doganore në llogarinë unike në DPD, nuk është kryer inventari i llogarisë parapaguese të çdo operatori ekonomik, me qëllim pasqyrimin real të gjendjes faktike të kësaj llogarie. Para unifikimit të llogarisë parapaguese në DPD, operatorët ekonomikë kanë kryer derdhje të shumave monetare në llogarinë parapaguese në një degë doganore, ndërkohë që

zhdoganimet i kanë kryer në degë të tjera. Si rezultat i këtyre veprimeve, operatorët kanë rezultuar debitorë në një degë doganore dhe kreditorë në një degë tjetër. Për këto arsye duhet të kryhej balancimi i debi/kredive të subjekteve (inventari) në të gjitha degët doganore. *Ky inventar nuk është kryer ende për të saktësuar gjendjen e llogarisë parapaguese në momentin e kalimit në DPD në muajin Qershor 2013, detyrë e lënë edhe nga auditi i brendshëm.* Edhe pse ka kaluar një periudhë dy vjeçare nga dalja e Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 8797, datë 04.04.2016 “Mbi rakordimin e llogarisë parapaguese”, ku kërkon:

-Rakordimin e llogarisë parapaguese për periudhën Shkurt 2009-Maj 2013 nga financierët e degëve; rakordimin e lëvizjeve në llogarinë parapaguese me të dhënat dërguara nga bankat për periudhën Maj 2013 e në vazhdim nga Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore; relativimin e rezultateve nga Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore në përfundim të proceseve më sipër. Gjendja e llogarisë parapaguese, sipas kontabilitetit me gjendjen e llogarisë parapaguese sipas sistemit Asycuda, për periudhën 2009-2016 rezulton me diferenca, për të cilat nuk janë evidentuar të gjitha shkaqet, por sipas Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës disa nga ata janë:

-Diferenca prej 307,971,226 lekësh (për periudhën 2009-2012) e cila nuk është korrektuar në kontabilitet me mbylljen e bilancit të vitit 2013, pasi korrektime të bëra vetëm për vitin ushtrimor 2013.

-Rimbursimi i akcizës në shumën 227,968,615 lekë, e cila nuk është zbritur nga të ardhurat llogaria 7031500, por janë zbritur padrejtësisht nga parapagimet.

-Deklaratat e thjeshtuara të cilat janë kredituar në sistem, por janë në proces debitimi manual nga Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr. 236-247 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Të përfundojë rakordimi i llogarisë parapaguese të sistemit Asycuda nga Zyrat e Financës së Degëve Doganore për periudhën para muajit Maj 2013, si dhe rakordimi nga Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore, me qëllim nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të balancës së llogarisë parapaguese.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pasqyrave financiare konstatohet se shpenzimet mbahen dhe regjistrohen mbi bazë Cash dhe jo mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Po kështu, nuk pasqyrohen në kontabilitet detyrimet për kontratat e lidhura më 29.12.2017, në shumën 55,192,704 lekë, si dhe detyrimet që kanë lindur nga vendimet gjyqësore, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 dhe nr. 10, datë 27.02.2008, Kapitulli III, si dhe me kërkesat e nenit 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

-Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se: Me urdhër shpenzimit nr. 1112, datë 29.12.2017, sipas kërkesës nr. 25898/1, datë 26.12.2017 të UNCTAD, i është likuiduar shuma 200,000 USD, ose 22,600 mijë lekë, shumë e cila është likuiduar paradhënie në kundërshtim me termat e kontratës së lidhur ndërmjet palëve, konkretisht pika E “Kontributet”, paragrafi i parë, veprimi i mësipërm është dhe në kundërshtim me pikën 147 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit të shtetit”, me ndryshime, pasi shuma e paradhënies është mbi 10% të kontratës, si dhe nuk është marrë miratimi paraprak i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr. 236-247 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit në DPD të marrë masa, që në të ardhmen të evidentojë të gjithë të drejtat dhe detyrimet në pasqyrat financiare të institucionit, në momentin e ndodhjes së

tyre, në përputhje me kërkesat kontabël dhe me kërkesat e nenit 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku citohet se “Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me: a) **njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës**”.

Në vazhdimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar mbi veprimtarinë e strukturave të personelit në DPD u konstatua se, struktura e DPD është miratuar me VKM nr. 9, datë 11.01.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014 të KM “Për personelin e administratës doganore”, por konstatohet se megjithëse ky vendim ka hyrë në fuqi brenda muajit janar 2017, *nuk është zbatuar edhe pse ka qenë vetë institucioni që ka rishikuar strukturën e tij dhe ka bërë propozimet për ndryshimin e vendimit të mësipërm.* Në muajin gusht 2017 janë bërë disa ndryshime, por strukturat apo sektorët e krijuar nuk kanë funksionuar, sikurse janë Sektori i Harmonizimit të Procedurave Doganore dhe Informimit të Operatorëve dhe Sektori i Lehtësive, Thjeshtimeve Doganore dhe Transitit, pasi nuk janë plotësuar me stafin e nevojshëm, duke raportuar 65 vende vakante në fund të vitit 2017 dhe 234 punonjës me transferim, ku 185 janë punonjës me status të nëpunësit civil, çka çënon vijimin normal të punës në DPD dhe Degë Doganore. Konstatohet se, nuk i është dhënë zgjidhje përfundimtare marrëdhënieve të punës për punonjësit e Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit, Drejtorisë së Hetimit, si dhe Drejtorisë Antitrafik, pasi aktualisht për punonjësit e kësaj kategorie nuk janë ndërprerë marrëdhëniet me statusin e nëpunësit civil dhe as lidhja e një kontrate të re punësimi, referuar gurmës “h” të nenit 2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr. 236-247 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Nga institucioni të merren masa për implementimin e plotë të strukturës së DPD, të miratuar me VKM nr. 2, datë 08.01.2018 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 921, datë 29.12.2014 të KM “Për personelin e administratës doganore”, ndryshuar me VKM nr. 9, datë 11.01.2017, me qëllim krijimin e një strukture eficiente, që gjatë vitit 2017 nuk është arritur të realizohet plotësisht.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2017, në zbatim të udhëzimit nr. 48, datë 08.12.2009 të Ministrisë së Financave “Për rregullat e shpërblimit të personelit doganor nga të ardhurat që realizohen nga sanksionet e shkeljeve doganore”, është përdorur fondi nga të ardhurat nga gjambat, sekuestrimet, kamat vonesat në shumën 13,156,742 lekë për shpërblim punonjësish, ndarë në dy 6-mujorë. Referuar udhëzimit janë dhënë shpërblime punonjësve sipas përcaktimeve të bërë në këtë udhëzim duke përfituar në tre mënyra: shpërblim të drejtpërdrejtë, shpërblim të tërthortë dhe shpërblim nga fondi i Drejtorit. Miratimi në % dhe vlerë sipas përcaktimeve të udhëzimit është bërë nga Bordi i Menaxherëve të DPD. Edhe pse nga auditimi i brendshëm është konstatuar që udhëzimi krijon problematikë në përlllogaritjen e të ardhurave nga sanksionet, pasi në disa raste janë përfshirë dhe të ardhurat që krijohen nga strukturat e jashtme të auditimit, si dhe ka rekomanduar hartimin e një udhëzimi të ri, deri më tani nuk ka gjetur zbatim rekomandimi e nuk është iniciuar hartimi i udhëzimit të ri, i cili duhet ti referohet dhe të sillet në kornizën e Kodit të ri Doganor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr. 236-247 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Departamenti Administrativ të marrë masa për hartimin e një udhëzimi të ri të shpërblimit nga të ardhurat, që realizohen nga sanksionet e shkeljeve doganore, *për ta sjellë atë në*

kornizën aktuale të Kodit të ri Doganor, tashmë në fuqi, ku të përcaktohen qartësisht raportet e përfitimit, shpërblimi nga kamatëvonesat, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga strukturat e jashtme të auditimit.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga Grupet e posaçme të punës dhe Njësia e Prokurimit në veprimtarinë e tyre, nuk kanë përmbushur kërkesat e objektit të ligjit, përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, sikurse kërkohet në nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika a dhe b, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të në kundërshtim me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime. Këtu theksojmë se edhe pse në nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar: “... Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT) ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.)...”, në asnjë rast në llogaritjen e fondit limit nuk janë marrë në konsideratë çmimet që mund të gjenerohen nga vetë sistemi doganor. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet nr. 248-257 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Grupet e punës apo njësia e prokurimit pranë AK, në të ardhmen të tregojë vëmendjen e duhur në përcaktimin e kriterëve kualifikuese në zhvillimin e procedurave të prokurimit, për të garantuar parimet mbi të cilat zhvillohen procedurat e prokurimit publik. Në hartimin e fondit limit AK të bazohet *në të dhënat e vetë administratës doganore*, ashtu sikurse përcaktohet dhe në nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të korrespondencës për borxhin me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) rezultoi se, në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 03.05.2017 “Për zbatimin e ligjit nr. 33/2017 “Për pagesën fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”, kap. IV- Fshirja e detyrimeve tatimore, pika 4, nga ana e DPT, me shkresën nr. 11562/1, datë 16.06.2017 është dërguar në DPD, lista e detyrimeve të tatimpaguesve për akcizë/gjobë/kamatëvonesa e dënim administrativ, për periudhën tatimore Janar 2011 deri më Dhjetor 2014, në shumën prej **12,029,713 mijë lekë.**

Nga ana e DPD nuk janë kontabilizuar detyrimet e tatimpaguesve për akcizë/gjobë/kamatëvonesa, *pasi kjo shkresë është refuzuar nga ana e DPD* sipas shkresës nr. 14634/4 prot., datë 31.07.2017, drejtuar Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe për dijeni Drejtores së Përgjithshme të Tatimeve, duke propozuar një ndryshim në Udhëzimin nr. 14, datë 03.05.2017 , me arsyetimin se DPD nuk mund të kontabilizojë detyrimet tatimore, pasi bien ndesh me nenin 2, pika 2, 9, 10 dhe 11 të ligjit nr. 33/2017, datë 30.03.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e

heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”, *pasi detyrimi i përcjellë me listë nga DPT i përket periudhës pas datës 31.12.2010.*

DPD, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 33/2017, datë 30.03.2017, **fshin dhe shuan** të gjitha detyrimet e dala nga vendime të administratës doganore, të cilat kontabilizohen në Degët Doganore, në të cilën ka përcaktuar gjithashtu dhe mënyrën e organizimit të kësaj procedure referuar Udhëzimit nr. 14, datë 03.05.2017 të Ministrisë së Financave. Aktualisht rezulton se detyrimi i akcizës nga DPT dhe nga DPD në shumën prej 12,029,713 mijë lekë nuk është i kontabilizuar si borxh në kontabilitetin e institucionit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet nr. 187-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa që të zgjidhë përfundimisht në mënyrë institucionale kontabilizimin e detyrimeve të akcizës në shumën prej 12,029,713 mijë lekë, që i përket periudhës Janar 2011 deri më Dhjetor 2014, sipas shkresës nr. 11562/1 prot., datë 16.06.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të refuzuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 14634/4 prot., datë 31.07.2017 drejtuar Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Financave.*

Menjëherë.

C. MASA SHPERBLIM DËMI

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave të marrë masa që të evidentojë detyrimet në kontabilitet dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e të ardhurave doganore të munguara në **Buxhetin e Shtetit në shumën 105,141,992 lekë, konkretisht:**

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për ankimimet administrative të kryera pranë Drejtorisë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për shkeljet në fushën doganore për periudhën nën auditim rezultuan vendimeve administrative të nxjerra nga Degët Doganore jo në përputhje me përcaktimet e neneve 256 dhe 261 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në dy raste, **në shumën 4,309,360 lekë**, për vendime administrative të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016 dhe 2017 nga Dega Doganore Fier dhe Durrës. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror juridiksional të kërkojë nga Degët Doganore Fier dhe Durrës, ndryshimin e dy vendimeve administrative në **shumën 4,309,360 lekë**, për rastet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve dhe gjobave doganore, bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar interpretimit të Avokaturës së Shtetit për mënyrën e evidentimit dhe nxjerrjes së përgjegjëseve për shkeljet doganore të kryera para datës 01.06.2017 (në këtë datë ka hyrë plotësisht në fuqi ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014), si dhe VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar.

Deri më 30.10.2018

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Hetimit rezultoi se, në procesverbalet e hartuara nga kjo drejtori për shkeljet doganore të kontrabandës, pjesë të dosjeve hetimore, nuk është kërkuar kontabilizimi i gjobës doganore **në shumën 416,944 lekë**, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aneksin nr. 1, dërguar për vendimmarrje administrative në degët doganore respektive, në mosrespektim të kërkesave të neneve 256.1.b, 256.2/3, 281/1, 282/2, 289 dhe 291 të ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor n Republikën e Shqipërisë”, shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 61, datë 25.08.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me strukturat e varësisë dhe struktura dhe organe të tjera hetimore e ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, të ndjekë me të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor, arkëtimin e sanksioneve dhe gjobave doganore për shkeljet doganore të kontrabandës **në shumën 416,944 lekë**, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe Udhëzimin nr. 6 datë 23.07.2013, “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”

Deri më 31.12.2018

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga personeli përpunues doganor në degët doganore respektive nuk janë rillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor, **në shumën 49,943,089 lekë**, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aneksin nr. 5, bashkëlidhur, që lidhen me vlerësimin doganor të vlerës së mallrave për qëllime doganore, bazuar në shpjegimet e neneve 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, pikës 2-5 të Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 të MF “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, Nomenklaturës së Mallrave në RSH, shkresës nr. 779prot., datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të analizojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, me qëllim kryerjen e procedurave doganore verifikuese sipas legjislacionit doganor në fuqi për vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në **shumën 49,943,089 lekë**, për praktika doganore që lidhen me rekomandime rillogaritjesh të detyrimeve doganore në import, për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e neneve 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 16.05.2006 të MF “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, Nomenklaturës së Mallrave në RSH, shkresës nr. 779prot., datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”.

Deri më 31.01.2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit, rezultuan veprime jo në përputhje me kërkesat dhe

përcaktimet e neneve 97, 98, 99 dhe 106 të ligjit nr 61/2012 “Për Akcizat në RSH”, me pasojë moskërkimin dhe moskontabilizimin e detyrimeve dhe sanksioneve doganore, për 4(katër) raste, **në shumën 13,255,638 lekë**, gjatë procedurës doganore të hartimit të akteve të konstatimit që lidhen me programe kontrolli të kryera nga kjo Drejtoria, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aneksin nr. 5, bashkëlidhur. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për kontabilizimin e detyrimeve doganore të akcizës, për 4 (katër) raste, **në shumën 13,255,638 lekë**, konform afateve dhe përcaktimeve ligjore të shprehura në ligjin specifik të fushës, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në Udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës“.

Deri më 31.01.2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Antikontrabandës rezultuan dosje kontrolli me mangësi, me pasojë mos evidentimin në aktet e konstatimit të mbajtura nga kjo drejtoria të detyrimeve doganore që duhet të ishin rillogaritur, në 18 raste subjektsh, **në shumën 5,124,767 lekë**, veprime në mospërputhje me kërkesat e neneve 256.1.b, 256.2/3, 281, 281/1, 289 dhe 291 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe aneksin nr. 2, bashkëlidhur tij).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente ku janë konstatuar shkeljet doganore, si struktura të varësisë, të ndjekë me të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor nxjerrjen e vendimeve administrative dhe kontabilizimin e detyrimeve në shumën **totale 5,124,767 lekë**, për 18 raste, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe Udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës“.

Deri më 31.12.2018

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës rezultuan deklarime të kushtit të origjinës të reduktuar MSABE jo në përputhje me shpjegimet e Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë” dalë sipas ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 për “Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit”, për të cilat nuk është dalë më vendimarrje nga degët doganore respektive, duke sjellë lindjen e detyrimeve doganore të shmangura **në shumën 7,780,990 lekë**, sipas rasteve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aneksin nr. 4, bashkëlidhur, veprime jo përputhje me ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 4, shkronja “g”, VKM nr. 180, datë 13.02.2013, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3.1, ligjit nr 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, neni 56, pika 38/a, VKM nr. 953, datë 29.12.2014, VKM nr. 84, datë 08.02.2017, duke sjellë lindjen e detyrimeve doganore të shmangura të TVSH-së në **shumën 3,538,535 lekë**, si dhe mospërputhje që lidhen me procedurat e Marrëveshjeve dhe Kuotave të Tregtisë së Lirë, kryesisht me reduktimin e kuotave doganore, ku u

konstatua një tejkalim kuote për artikullin “verë” deklaruar në kodin tarifor *220410*, *220421* “verë nga rrush i freskët deri në 2 litra”, në sasinë 32,530 litra, me një detyrim doganor **në shumën 4,546,265 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me strukturat e saj të varësisë, të ndjekë me të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni doganor nxjerrjen e vendimeve administrative dhe kontabilizimin e borxhit doganor **në shumën 15,865,790 lekë**, me qëllim arkëtimin e borxhit doganor që do të lindë bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”.

Deri më 31.01.2019

7. Gjetje nga auditimi: Pas kontrollit aposterior në terren nga **Spektori i Kontrollit të Vlerës, Klasifikimit, Origjinës**, Degët Doganore Kakavijë, Kapshticë, Tiranë, Fier për subjektet “D...”; “E...S...”; “G...Company” **nuk kanë dalë me vendim administrativ** për shkeljen e konstatuar nga kontrolli aposterior pas marrjes dijeni prej tyre. Nga mosveprimi referuar nenit 276 të KD, efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit **në total është 15,566,448 lekë**.

-Pas kontrollit aposterior nga zyra, nga **Spektori i Kontrollit të Vlerës, Klasifikimit, Origjinës** Degët Doganore Kakavijë, Tiranë, Fier për subjektet “E...S...”; “Demi D”; “D...sha”; “Z...” **nuk kanë dalë me vendim administrativ** për shkeljen e konstatuar nga kontrolli aposterior pas marrjes dijeni prej tyre për procesverbalin e kontrollit aposterior. Nga mosveprimi referuar nenit 276 të KD, efekti financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit **në total është 659,956 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 45-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore të ndjekin të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në **shumën 16,226,404 lekë**, sipas Aneksit bashkëlidhur.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, që në vlerësim të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave si më poshtë:

I. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, sipas nenit 58, germa “c”, për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për znj. A...D.... me detyrë ZV/Drejtor i Përgjithshëm i Doganave:

-për shkeljet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore gjatë ushtrimit dhe përfundimit të program kontrolleve të Drejtorisë së Kontrollit dhe Metodikave, gjatë procedurës së dhënies së informacionit dhe të marrjes dijeni për veprimtarinë e kryer gjatë hartimit të akteve, në kundërshtim

me nenet 97, 98, 99 dhe 106 të ligjit nr. 61, datë 25.08.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktimeve të detyrave funksionale të shefit të Departamentit të Akcizës pranë DPD-së, referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 67 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, miratuar me shkresën nr. 9745/4, datë 09.03.2016 dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 7, datë 03.08.2017 “Mbi procedurat e Mostrimit transportimit, ruajtjes së mostrave dhe administrimit të rezultateve laboratorike”.

2. Për znj. A...G..., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Pijeve Alkolike në Drejtorinë e Metodikave dhe Kontrollit, pranë Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

-për shkeljet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore gjatë ushtrimit dhe përfundimit të program kontrolleve të Drejtorisë së Kontrollit dhe Metodikave, gjatë procedurës së hartimit të akteve të konstatimit në formën e proces-verbalit, në kundërshtim me nenet 97, 98, 99 dhe 106 të ligjit nr. 61, datë 25.08.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe përcaktimeve të detyrave funksionale të sektorit në referuar pikës 4.1 “Detyrat e funksionimit të sektorit të produkteve alkolike” të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

(Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 125 deri në faqe 142).

3. Për z. E...D..., me detyrë Komandant Grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

4. Për z. S...Y..., me detyrë Komandant i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

5. Për z. H...S..., me detyrë Komandant i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

6. Për z. S...H..., me detyrë Komandant i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor:

-për shkeljet të përsëritura të konstatuara gjatë kryerjes së detyrave funksionale dhe hartimit të akteve administrative në kundërshtim me ligjin nr. 84491 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe përcaktimeve të detyrave funksionale të Komandantit të Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor referuar “Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” e protokolluar me shkresën e DPD nr. 10168prot., datë 07.06.2011.

(Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 142 deri në faqe 169).

II. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” sipas nenit 58, germa “b”, për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për z. E...C..., me detyrë specialist hetues pranë Drejtorisë së Hetimit, në Departamentin Operativ-Hetimor:

-për problemet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore gjatë ushtrimit dhe përfundimit të dosjeve hetimore të Drejtorisë së Hetimit dhe hartimit të akteve në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktimeve të detyrave

funkzionale të specialistit të Drejtorisë së Hetimit referuar "*Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*", miratuar me shkresën nr. 10168prot., datë 07.06.2011;
-veprime jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e neneve 256.1.b, 256.2/3, 281, 281/1, 289 dhe 291 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 "*Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.

2. Për z. A...S...., me detyrë specialist hetues pranë Drejtorisë së Hetimit në Departamentin Operativ-Hetimor .

-për shkeljet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore gjatë ushtrimit dhe përfundimit të dosjeve hetimore të Drejtorisë së Hetimit dhe hartimit të akteve, në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, përcaktimeve të detyrave funksionale të specialistit të Drejtorisë së Hetimit referuar "*Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*" e protokolluar me shkresën e DPD nr. 10168prot., datë 07.06.2011,
-Veprime jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e neneve 256.1.b, 256.2/3, 281, 281/1, 289 dhe 291 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "*Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë*".
(*Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 85 deri në faqe 109*).

3. Për z. D...S...., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

4. Për z. E...L...., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

5. Për z. Y...K...., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

6. Për z. Y...S...., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

7. Për z. F...O...., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

8. Për z. B...P...., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor,

9. Për z. A...U...., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor dhe

10. Për z. G...U...., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor:

-për shkeljet të përsëritura të konstatuara gjatë kryerjes së detyrave funksionale dhe hartimit të akteve administrative në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*" i shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, si dhe përcaktimeve të detyrave funksionale të Inspektorit të Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor referuar "*Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*", e protokolluar me shkresën e DPD nr. 10168prot., datë 07.06.2011.

(*Shih trajtimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 142 deri në faqe 169*).

E. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar

Shënim: Për çështje të veçanta, ky auditim vlerësohet dobët nga Kryetari dhe Drejtori i Departamentit. Kjo periudhë do riauditohet në auditimin e radhës në vitin 2019, ose do të analizohet përmes kontrollit të cilësisë në të ftohtë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R